



Në pajtim me autoritetin që i është dhënë përmes Ligjit Nr. 03/L-090 mbi Partneritetet Publiko - Private dhe Koncesionet në infrastrukturë si dhe procedurat për dhënien e tyre, Neni 12, Paragrafi 2.3, Komisioni Drejtues Ndërmënytor për Partneritetet Publiko-Private (KDNM-PPP) miraton këtë:

DIREKTIVË NR. 2 / 2011

Për Ekipet për Menaxhimin e Projekteve

Neni 1: Përkufizimet

Termet e përdorur në këtë Direktivë, përveç nëse përcaktohet ndryshe, do ta kenë kuptimin e përcaktuar në Ligjin mbi PPP.

Neni 2: Krijimi i Ekipeve për Menaxhimin e Projekteve

1. Çdo autoritet publik, i cili ka hyrë në një marrëveshje për PPP në pajtim me Ligjin mbi PPP dhe rregullat e tjera të nxjerra nga KDNM-PPP, duhet të themelojë dhe të mbajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së një marrëveshjeje të tillë PPP një Ekip për Menaxhim të Projektit. Autoriteti publik mund t'i caktojë në një Ekip të tillë për menaxhimin e projektit nëpunës civilë të kualifikuar dhe me përvojë, në përputhje me rregullat e prokurimit në fuqi, dhe të kontraktojë persona ligjor dhe fizik me kualifikime përkatëse për të ofruar shërbimet e kërkuara të Ekipit për Menaxhim të Projektit.
2. Ekipi për Menaxhim të Projektit do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes PPP dhe për të siguruar përmbushjen e kushteve të kësaj marrëveshjeje nga partneri privat. Njësia Qendrore e PPP do t'i përcaktojë termet e referencës të detajuara për Ekipet e tilla për menaxhim të projekteve.

Neni 3: Financimi i një Ekipi për Menaxhim të projektit

Autoriteti publik, i cili ka themeluar Ekipin për Menaxhim të Projektit, do t'i sigurojë fondet e nevojshme për personelin dhe operimin e Ekipit për Menaxhim të Projektit.

Neni 4: Përbërja e një Ekipi për Menaxhim të Projektit

Ekipi për menaxhim të projektit do të përbëhet nga ekspertë të kualifikuar dhe me përvojë në fushën e menaxhimit të projekteve, kontratave, financave dhe buxhetit, dhe me përvojë të domosdoshme teknike dhe inxhinierike, siç mund të jetë domosdoshme për projekte specifike të PPP.

Neni 5: Raportimi dhe udhëzimet

1. Ekipi për Menaxhim të Projektit duhet të raportojë në baza të rregullta, apo siç kërkohet, tek autoriteti publik dhe KDNM-PPP nëpërmjet Njesisë Qendrore të PPP për çështjet që ndërlidhen me zbatimin e marrëveshjes PPP. Në rast se Ekipi për Menaxhim të Projektit mëson për fakte të cilat mund të rezultojnë në mospërmbushje të marrëveshjes PPP nga ana e partnerit privat, ose për ndonjë formë tjetër të shkeljes së detyrimeve në përputhje me marrëveshjen PPP, duhet menjëherë të informojë me shkrim autoritetin publik dhe KDNM-PPP, nëpërmjet Njesisë Qendrore të PPP, në lidhje me faktet e tilla dhe pasojat e mundshme dhe do t'i rekomandoj veprimet që duhet të ndërmerren.
2. Ekipi për Menaxhimin e Projektit do t'i bindet çdo udhëzimi të nxjerrë nga autoriteti publik dhe KDNM-PPP nëpërmjet Njesisë Qendrore të PPP.

Neni 6: Hyrja në fuqi

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të tij nga ana e KDNM-PPP dhe nënshkrimit të tij nga Kryesuesi i KDNM-PPP.

